

**VENDIM**  
**Nr. 558, datë 15.7.2020**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 325, DATË 23.6.2000, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E QENDRËS KOMBËTARE ‘PËR MIRËRRITJEN, ZHVILLIMIN DHE REHABILITIMIN E FËMIJËVE’, SI NJËSI BUXHETORE, E VEÇANTË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17, të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

I. Në vendimin nr. 325, datë 23.6.2000, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në vendim, emërtimi “Qendra Kombëtare ‘Për mirërritjen, zhvillimin dhe rehabilitimin e fëmijëve’” zëvendësohet me “Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët”.

2. Pas pikës 2 shtohen pikat 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4, me këtë përmbajtje:

“2.1 Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët është institucion që ofron shërbime të shëndetit mendor, në lidhje me diagnostikimin, trajtimin, kujdesin terapeutik dhe rehabilitimin e aftësisë së kufizuar për fëmijët.

2.2 Drejtori i Përgjithshëm i Qendrës Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët emërohet, lirohet ose shkarkohet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

2.3 Shërbimet ofrohen nga ekupe multidisciplinare të përbëra nga specialistë të disa fushave, si: mjekë, infermierë, psikologë, punonjës socialë, terapistë okupacionalë, logopedistë, terapistë zhvillimi, ergoterapistë, fizioterapistë, terapistë psikomotorë dhe specialistë të tjerë të profilit mjekësor, të cilët veprojnë në mënyrë të koordinuar, sipas roleve dhe përgjegjësi të përkrahura në rregulloren e brendshme të institucionit.

2.4 Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët, udhërrëfyesit dhe standardet e kujdesit shëndetësor e social miratohen nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.”.

II. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**